



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 26 mars 2015
Nr. ref.: RK 783/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI183/14

Parashtrues

Ilir Berisha

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit të Komisionit për Emërim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ref. ZVVGJ/0389/14, të 22 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Ilir Berisha (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit Ref. ZVVGJ/0389/14 të Komisionit për Emërim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK), të 22 shtatorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Njoftimit [Ref. ZVVGJ/0389/14] të KGJK-së, të 22 shtatorit 2014, me të cilin pretendohet shkelja e të drejtave dhe lirive të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me: nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe të neneve 6, 7 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI183/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI183/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 27 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe KGJK-në për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 12 shkurt 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 4 shkurt 2014, KGJK-ja kishte shpallur konkurs për pranimin e një numri të caktuar të gjyqtarëve. Në konkurs, KGJK-ja kishte përcaktuar kushtet që kandidatët duhet t'i përmbushnin gjatë aplikimit, të cilat janë të përcaktuara në nenin 26, paragrafi 1 i Ligjit për gjykatat.
10. Parashtruesi i kërkesës, në afatin e paraparë në konkurs, aplikoi për pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Pejë.

11. Më 25 shtator 2014, KGJK-ja vendosi ta refuzojë aplikacionin e parashtruesit të kërkesës për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Komunale në Pejë. KGJK-ja i dërgoi njoftimin [Ref. ZVVGJ/0389/14], duke e informuar parashtruesin e kërkesës lidhur me arsyet për vendimin e saj. Aplikacioni ishte refuzuar, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk e ka përmbushur kriterin e përvojës së punës, siç parashihet me Ligj (Neni 26, paragrafi 1 i Ligjit për gjykatat).
12. Më 29 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës, konsideron se KGJK-ja kishte bërë gabim në vërtetimin e fakteve lidhur me përvojën e tij të punës. Prandaj, ai ka paraqitur kundërshtim pranë Komisionit të shkallës së dytë të KGJK-së, duke kërkuar rishqyrtimin e aplikacionit të tij.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi në kërkesë deklaroi: *“... se ai konsideron se në rastin e tij janë shkelur të drejtat dhe liritë nga neni 3 [Barazia para Ligjit], neni 7 [Vlerat], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Kosovës; si dhe neneve 6, 7 dhe 14 të KEDNJ, si dhe shkeljet ende vazhdojnë”*.
14. Parashtruesi në kërkesën e tij kërkon nga Gjykata:
 - *„Të deklaroj kërkesën të pranueshme,*
 - *Të konstatohet se ka shkelje të dispozitave të neneve 3, 7, 24, 32 dhe 49 të Kushtetutës, si dhe neneve 6, 7 dhe 14 të KEDNJ,*
 - *Të anulohet Njoftimi Ref. ZVVGJ/0389/14 të datës 22 shtator 2014 të Komisionit për Emërim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si kundërkushtetues,*
 - *Të urdhërohet KGJK-në, eliminimin e shkeljeve të dispozitave të cekura më lart“.*

Pranueshmëria e kërkesës

15. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

„Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
17. Përveç kësaj, neni 47.2 i Ligjit, gjithashtu, përcakton se:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
18. Për më tepër, rregulli 36 (1) b) përcakton:

“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”.

19. Parashtruesi në kërkesë thekson se me Njoftimin [Ref. ZVVGJ/0389/14] të KGJK-së të 22 shtatorit 2014, i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe KEDNJ, të cituara në paragrafin 12 të këtij raporti.
20. Parashtruesi nuk ka dorëzuar në Gjykatë përgjigjen e KGJK-së, nëse ka, ndaj kundërshtimit të tij dhe kërkesën e 29 shtatorit 2014. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar nëse ai ka bërë ndonjë përpjekje tjetër përmes mjeteve të tjera juridike për t'i siguruar të drejtat, si ato ligjore ashtu edhe ato kushtetuese, të cilat ai tani pretendon se i ishin shkelur, para parashtrimit të kërkesës së tij në Gjykatë.
21. Prandaj, Gjykata konsideron se në këtë rast, kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, pasi që procedura e parashtruesit për rishqyrtim të aplikacionit të tij para organit të shkallës së dytë të KGJK-së është ende në pritje.
22. Përveç kësaj, Gjykata vëren se ekzistojnë mjete tjera administrative, të cilat ai mund t'i shterë lidhur me ankesat e tij.
23. Gjykata thekson se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi t'i shterë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalojë shkeljen e Kushtetutës, nëse ka, apo të korrigjojë shkeljet e tilla të të drejtave themelore të njeriut.
24. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'iu lejojë autoriteteve kompetente, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë të parandalojnë apo korrigjojnë shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin që rendi juridik i Kosovës ofron mjete efektive juridike për mbrojtje kundër shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih Aktvendimin për papranueshmëri: *AAB-RIINVEST Universiteti SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, vendim i 28 korrikut 1999).
25. Në përfundim, Gjykata konsideron se në këtë rast nuk ka vendim përfundimtar nga organi kompetent i cili do të mund të shqyrtohej, dhe i cili mund të ishte bazë për shkeljet e pretenduara.
26. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 26 mars 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani